

Njoftim për konsultimin publik, lidhur me:

Udhërrëfyesin për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030

Udhërrëfyesi Kombëtar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026–2030 është dokument kombëtar orientues që përkthen “Agjendën 2030” të Kombeve të Bashkuara në një kornizë të zbatueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë. Udhërrëfyesi përfaqëson një hartë strategjike kombëtare, që përcakton ku ndodhet Shqipëria në raport me 17 objektivat, cilat janë synimet për vitin 2030, dhe si matet progresi drejt tyre.

Gjithashtu, dokumenti ndërton një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet objektivave globale të Agjendës 2030 dhe objektivave kombëtare të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE), duke siguruar që çdo politikë dhe program zhvillimi të kontribuojë në arritjen e rezultateve të matshme në kuadër të qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendit. Dokumenti mbështetet në një qasje të integruar të zhvillimit, ku dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërthuren në mënyrë të balancuar, ndërsa adreson çështjet kyçe të zhvillimit të vendit nëpërmjet 5 fushave ndërvepruese – njerëzit, planeti, prosperiteti, paqja dhe partneritetet (5P) – në përputhje me logjikën e Agjendës Globale 2030.

Për çdo objektiv, dokumenti përcakton:

- synimet kombëtare deri në vitin 2030, të përkthyer nga objektivat globale në rezultate konkrete për Shqipërinë;
- treguesit e matjes, të përafruar me standardet ndërkombëtare dhe të integruar me indikatorët e SKZHIE 2030;
- lidhjet ndërsektoriale, që tregojnë mënyrën se si përmbushja e një objektivi ndikon në përparimin e të tjerëve, duke nxitur sinergji dhe bashkërendim politikash.

Në qendër të Udhërrëfyesit qëndron zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm, me theks të veçantë tek reduktimi i varfërisë, ulja e pabarazive, përmirësimi i cilësisë së jetës, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe përforcimi i institucioneve demokratike.

Përmes këtij dokumenti, zhvillimi ekonomik shihet jo si qëllim në vetvete, por si mjet për mirëqenie sociale dhe barazi, duke garantuar që asnjë grup apo rajon të mos mbetet pas.

Nëpërmjet tij, Shqipëria:

- përcakton objektivat e matshëm kombëtarë për secilin prej 17 OZHQ-ve;
- harmonizon treguesit e zhvillimit kombëtar me metodologjinë e Kombeve të Bashkuara dhe me standardet e Bashkimit Evropian;
- vendos një bazë për monitorim dhe raportim periodik të progresit kombëtar;
- orientohet drejt politikave publike të bazuara në evidencë, duke forcuar lidhjen ndërmjet planifikimit strategjik, buxhetimit dhe vlerësimit të ndikimit.

Udhërrëfyesi i OZHQ-ve është në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare, integrimin në Bashkimin Evropian dhe angazhimet ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe Agjendën 2030 të OKB-së.

Udhërrëfyesi është hartuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në bashkëpunim me ministritë e linjës, INSTAT dhe institucione të tjera relevante.

Palët e interesuara janë të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për këtë draft udhërrëfyese, brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së këtij njoftimi, në adresën e email-it të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: suela.kongjini@saspac.gov.al.

Më poshtë gjendet e publikuar:

1. Udhërrëfyesi i OZHQ-ve 2026–2030;
2. Relacioni i projektvendimit “Për miratimin e Udhërrëfyesis për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026-2030”.